



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

URDHËR

Nr. 203 Datë 15/06/2011

PËR PROCEDURËN E ETIKETIMIT

Në zbatim të Vendimit Nr. 1344, datë 10.10.2008 “ Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore” procedura që duhet të ndiqet është si më poshtë vijon.

1. Të gjitha Drejtoritë Rajonale të përcjellin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në Sektorin e Mbikëqyrjes së Tregut dhe Informimit të Shpejtë të gjitha kërkesat për notifikim / miratim etikete që i paraqiten atyre nga subjektet e interesuara.
2. Brënda pesë ditëve nga marrja e kërkesës Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Informimit të Shpejtë kthen një përgjigje në të cilën reflekton plotësimin e kushteve ligjore për etiketën e paraqitur nga ana e subjekteve të interesuara.
3. Përgjigja plotësohet në tre kopje, një për subjektin e interesuar dhe një për Drejtorinë Rajonale e cila ka përcjellë kërkesën. Pas kthimit të përgjigjes etiketat futen në bazën e të dhënave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
4. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen të gjitha Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Informimit të Shpejtë në Drejtorinë e Përgjithshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

